

Deputetet e Kuvendit të Kosovës po marrin rroga, edhe pse Kuvendi nuk po funksionon. Madje, buxhetit të varfër të Kosovës kjo jo pak po i kushton.

Këtë e bënë me dije edhe Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, përmes një përgjigje elektronike për TV Rrokum. Ai tha se janë procesuar edhe rrogat e muajit të kaluar.

“Për periudhën 17 korrik - 31 tetor, për 107 deputetë janë paguar në total 562 mijë euro. Nuk ka pasë pagesë për 12 deputetë që kane pozita në Qeveri”, shkroi ai.

Ndryshe, deputetet për gjysmën e muajit korrik kanë marrë 744 euro rrogë, për të vazhduar pastaj me rrogën e plotë që ashtë 1488 euro në muaj.

Analisti Shpend Kursani nuk fajëson partitë apo deputetet, por Kushtetuesen që e solli këtë ngërç dhe që e ka përcaktuar këtë situatë që deputet të marrin rroga edhe pa u kompletua konstituimi i Kuvendit. Ndërsa, Albert Krasniqi nga KIPRED vlerëson se pagat janë të arsyeshme pasi, sipas tij, nëse kërkohet që deputetet të heqin dorë nga postet tjera, atëherë nuk mund t’ju mohohet paga e deputetit.

Por, për qytetarët kjo gjë është absurde dhe e turpshme.

Deputetet e Kuvendit të Kosovës, pos rrogës që marrin, u paguhen mëditjet edhe për mbajtjen e seancave, për udhëtime, si dhe për mbledhjet nëpër komisione. Sipas Ligjit për deputetë, paga për një vit marrin edhe deputetet tjerë që nuk kanë arritur me qenë pjesë e kësaj legjislature. /Rrokum/

[562 MIJË EURO PAGA, PËR DEPUTETET E “PAPUNË”](#) by [RrokumTelevision](#)